



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës
Opstina Mitrovica – Municipality of Mitrovica

DREJTORIA E INSPEKSIONIT

01-030/01-0013023/26

10.03.2026

PËR/ZA/TO:	z. Faton PEÇI – Kryetar i Komunës
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Bedri MUJA – Zyrtar i Lartë Ligjor
NGA/OD/FROM:	z. Mujë IGRISHTA – Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Plani Vjetor i Punës për vitin 2026 i Drejtorisë së Inspeksionit
DATA/DATUM/DATE:	05.03.2026

PLANI VJETOR I PUNËS
I
DREJTORISË SË INSPEKSIONIT

Mars 2026

PËRMBAJTJA

Hyrje	3
Baza ligjore	3
Drejtoria e Inspekcioni	3
Misioni	4
Qellimet e Përgjithshme.....	4
Sfidat aktuale të Drejtorisë së Inspekcioni	4
Aktivitetet e Drejtorisë	5
Organizimi dhe Plani Inspektues	5
Prioritetet e Punës	5
Objektivat Strategjike për vitin 2026	5
Kapaciteti dhe Struktura e Drejtorisë së Inspekcioni	6
Metodologjia e Mbikëqyrjes Inspektuese	6
Planifikimi - Numri i Inspektimeve të Parashikuara	6
Planifikimi i Inspektimeve Bazuar në Risk	7
Zonat me Risk të Lartë në Mitrovicën e Jugut	7
Kategoritë e Riskut	7
Numri i Inspektimeve të Bazuara në Risk	8
Sektori i Tregut	9
Sektori i Shërbimeve Publike dhe Mbrojtje të Mjedisit	17
Sektori i Ndërtimit	26
Sektori i Transportit Rrugor	35
Indikatorët e Përformancës	43
Përfundim	43

TABELAT

Tabela 1: Sektori i Tregut – Objektivat dhe aktivitetet e Planit Vjetor të Punës për vitin 2026	7
Tabela 1.1: Janar – Shkurt	8
Tabela 1.2: Mars – Prill	9
Tabela 1.3: Maj – Qershor	10
Tabela 1.4: Korrik – Gusht	11
Tabela 1.5: Shtator – Tetor	12
Tabela 1.6: Nëntor – Dhjetor	13
Tabela 2: Sektori i Shërbimeve Publike dhe Mbrojtje të Mjedisit – Objektivat dhe aktivitetet e Planit Vjetor të Punës për vitin 2026	17
Tabela 2.1: Janar – Shkurt	18
Tabela 2.2: Mars	19
Tabela 2.3: Prill - Maj	20
Tabela 2.4: Qershor – Korrik	21
Tabela 2.5: Gusht – Shtator	22
Tabela 2.6: Tetor – Nëntor	23
Tabela 2.7: Dhjetor	24
Tabela 3: Sektori i Ndërtimit – Objektivat dhe aktivitetet e Planit Vjetor të Punës për vitin 2026	27
Tabela 3.1: Janar – Shkurt	28
Tabela 3.2: Mars – Prill	29
Tabela 3.3: Maj – Qershor	30
Tabela 3.4: Korrik - Gusht	31
Tabela 3.5: Shtator – Tetor	32
Tabela 3.6: Nëntor	33
Tabela 3.7: Dhjetor	34
Tabela 4: Sektori i Transportit Rrugor - Objektivat dhe aktivitetet e Planit Vjetor të Punës për Vitin 2026.....	37
Tabela 4.1: Janar – Shkurt	38
Tabela 4.2: Mars – Prill	39
Tabela 4.3: Maj- Qershor	40
Tabela 4.4: Korrik – Gusht	41
Tabela 4.5: Shtator – Tetor	42
Tabela 4.6: Nëntor – Dhjetor	43

1. Hyrje

Plani Vjetor i Punës i Drejtorisë së Inspekcionit të Komunës së Mitrovicës së Jugut përcakton objektivat, aktivitetet dhe indikatorët e performancës për të siguruar rend ligjor, cilësi të shërbimeve dhe zbatim politikave komunale konform legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës dhe akteve normative në Komunën e Mitrovicës së Jugut.

Inspektorati Komunal ka rol kyç në funksionimin e komunës pasi që konform autorizimeve dhe kompetencave të saj, mbikëqyrë sektorët kritikë si: mjedisi, ndërtimi, transporti rrugor, tregu, rendi komunal dhe shërbimet publike.

2. Baza ligjore

Plani Vjetor i Punës i Drejtorisë së Inspekcionit bazohet në kompetencat dhe përgjegjësit që dalin nga dispozitat ligjore dhe nënligjore të listuara si më poshtë dhe jo vetëm:

- Ligji nr. 03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale;
- Ligji nr. 08/L-067 për Inspektimet;
- Ligji nr. 08/L-279 për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut;
- Ligji 04/L- 175 për Inspektoratin e Ujrave, Natyrës, Planifikimit dhe të Ndërtimit;
- Ligjit nr. 04/L-179 Për Transportin Rrugor dhe Ligjit nr. 06/L-070;
- Statutin e K.K. Mitrovicë e Jugut;
- Rregulloren nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale;
- Rregulloren nr. 03/2012 për Shërbime Publike Komunale dhe Rend Komunal, si dhe akte tjera ligjore dhe nënligjore përfshirë plotësim-ndryshimet e akteve respektive;
- Rregulloren nr. 01/2023 për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike.

3. Drejtoria e Inspekcionit

Drejtoria e Inspekcionit do të jetë përgjegjëse për performancën e detyrave si në vijim:

- a. Mbikëqyrjen dhe aplikimin e ligjeve dhe akteve tjera ligjore në fushën e ndërtimit, tregut, bujqësisë, mbrojtjen e ambientit, trafikut urban-komunikacionit, hidroekonomisë, rrugëve etj;
- b. Implementimin e praktikave të Inspekcionit të tregut duke përfshirë shitjen ilegale të të mirave materiale, afatin e përdorimit të artikujve, ushtrimin e biznesit në pajtueshmëri me orarin e punës;
- c. Të sigurojë mbrojtjen efektive të konsumatorit, fillimisht përmes inspektimit të artikujve ushqimor, mishit, shpezëve dhe prodhimeve të qumështit;
- d. Të sigurojë standarde të larta në lëmin e mbrojtjes së ambientit;
- e. Mbikëqyrë implementimin e Planit Zhvillimor të Komunës (PZHK), planeve zhvillimore urbane (PZHU), planeve rregulluese urbane (PRRU), kushteve e lokacionit dhe të ndërtimit, përkatësisht të rikonstruimit të objekteve industriale, të objekteve për prodhim dhe qarkullim të mallrave, të ndërtesave banesore dhe ndërtesave tjera, të varrezave, objekteve për furnizim me ujë, objekteve të komunikacionit;
- f. Të zbatojë inspektimin në lëmin e ndërtimit dhe rindërtimit për të siguruar pajtueshmëri me rregulla të ndërtimit dhe planifikimit, me theks të veçantë në ndërtimin ilegal;
- g. Të sigurojë inspektimin në lëmin e shërbimeve komunale me theks të veçantë në transportin publik duke inspektuar shërbimet e autobusëve, lejet e taksive dhe objektet transportuese publik;
- h. Ekzekuton vendimet, përcjell, evidenton dhe ndërmerr masa ligjore ndaj subjekteve-operatorëve që kryejnë veprimtari joligjore nga kompetenca e kësaj drejtorie;
- i. Përgatitë aksione konkrete për eliminimin e të metave që paraqiten në rast konkrete në bashkëveprim me organet tjera kompetente si dhe bashkëvepron me subjektet shtetërore si: policia, gjykata, prokuroria etj;

- j. Të kryejë detyrat dhe përgjegjësitë në bashkëpunim të ngushtë me drejtoritë tjera të komunës.

4. Misioni

Në zbatim të ligjeve dhe akteve tjera ligjore, Drejtoria e Inspekcionit ka mision kryesor mbrojtjen e interesit publik dhe interesat e ligjshme të personave juridik dhe fizik. Inspektori komunal duhet të jetë i orientuar nga pasioni dhe profesionalizmi si pjesë e institucionit përkatës i cili nxit konsolidimin e sjelljeve dhe vlerave etike të çdo punonjësi gjatë ushtrimit të funksionit.

5. Qëllimet e Përgjithshme

5.1. Inspektimet kanë për qëllim:

- Mbajtjen e rendit ligjor në kuadër të fushë veprimtarisë dhe aktiviteteve të veta;
- Mbrojtja e interesit të përgjithshëm publik;
- Mbrojtja e interesave të ligjshme të subjekteve të inspektimit;

5.2. Qëllimet e inspektimit arrihen nëpërmjet:

- Respektimi i parimeve ligjore;
- Zbatimin e ligjeve dhe akteve tjera nënligjore;
- Respektimi i kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit;
- Këshillimi i subjektit të inspektimit për zbatimin sa më korrekt të kërkesave ligjore;
- Urdhërimi për korrigjim të shkeljeve ligjore dhe eliminimin e pasojave që dalin prej tyre;
- Shqiptimi i dënimeve, marrja e masave tjera administrative;
- Inicimi i Procedurës Kundërvajtëse dhe Kallëzime Penale.

6. Sfidat aktuale të Drejtorisë së Inspekcionit

- Deponi ilegale të përsëritura (në lagjen e romëve, në skaj të magjistrales Mitrovicë-Leposaviç afër kërshit të Dudës, Zhabar etj).
- Hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve dhe pastërtia jo e qëndrueshme.
- Ndërtimet e paligjshme në periferi dhe në zona me interes ekonomik.
- Shfrytëzimi i paligjshëm i sipërfaqeve publike dhe objekteve në pronësi të komunës.
- Shitësit ambulant.
- Operimi i bizneseve të pa regjistruara.
- Trafiku i ngarkuar, parkingjet e pa rregullta dhe riorganizimi i parkingjeve.
- Transporti i ilegal, i pa organizuar i njerzëve dhe mallrave, etj.

7. Aktivitetet e drejtorisë

Në realizimin objektivave të inspektimit në Drejtorinë e Inspekcionit, parashihen këto aktivitete:

- Inspektimi i veprimtarive-subjekteve afariste;
- Shqyrtimi dhe përgjigja në kërkesa zyrtare;
- Trajtimi i rasteve ad-hoc;
- Hartimi i procesverbaleve, nxjerrja e vendimeve dhe akteve tjera si dhe ekzekutimit i tyre;
- Inicimi i procedurave kundërvajtëse dhe kallëzimeve penale.

8. Organizimi dhe Plan i Inspektues

- Inspektimi do të realizohet në tërësi duke e mbuluar territorin e Mitrovicës së Jugut;
- Drejtoria e Inspekcionit do të organizohet në grupe inspektuese të kombinuara sipas nevojës;
- Angazhimi në grupe do të bëhet me rotacion, ndërsa inspektorët e lirë do të angazhohen në punë tjera si: kujdestari, përgjigja në kërkesa zyrtare, inspektime ad-hoc dhe punë administrative;
- Inspektimi në teren do të filloj si rregull nga ora 9⁰⁰-14⁰⁰, ndërsa sipas rrethanave dhe kërkesave mund të zgjasë edhe më shumë;
- Angazhimi i një ekipi inspektues - kujdestar sipas nevojës (pas orarit të rregullt të punës).

9. Prioritetet e punës

Drejtorja e Inspekcionit në realizimin e planit të punës, bazohet në trajtimin e çështjeve sipas rëndësisë. Andaj duke u bazuar në këtë, në kryerjen e detyrave dhe realizimin e objektivave, Drejtoria e Inspekcionit ka për bazë njërin nga kriteret e mëposhtme:

- **Inspektime të rëndësisë së përgjithshme** - janë inspektime që bëhen në subjekte të cilat inspektohen në intervale dhe kohë të caktuara, karakteri dhe rëndësia e të cilave mund të jenë të ndryshme, por funksionimi i tyre është i rregullt dhe si të tilla janë të parashikuara. Organizimi i inspektimit në këto subjekte do të bëhet sipas rëndësisë, kohës dhe karakterit të tyre. Këto inspektime në mënyrë të përgjithshme janë të paraqitura si më poshtë në mënyrë tabelore sipas sektorëve të kësaj drejtorie.

- **Inspektime të rëndësisë së veçantë** - janë inspektime si rregull të pa parashikuara, të cilat për nga rëndësia dhe karakteri kërkojnë intervenim të veçantë. Këto inspektime nuk mund të parashikohen dhe të realizohen në agjendë të rregullt, mirëpo trajtimin e tyre do të bëhet me prioritet. Inspektime të rëndësisë së veçantë ishte rasti me pandeminë Covid 19, rastet të cilat paraqiten si aksidente apo dukuri të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e njerzëve. Në këtë kategori hyjnë edhe kërkesat zyrtare dhe kërkesat dhe ankesat tjera që paraqiten në institucionin tonë.

10. Objektivat strategjike për vitin 2026

10.1. Ngritja e efikasitetit të inspektimeve

- Plan mujor dhe javor të inspektimeve
- Rritja e numrit të inspektimeve në fushat me rrezik të lartë
- Organizimi i trajnimeve të inspektorëve.

10.2. Reduktimi i shkeljeve të ligjore

- Zbatimi i procedurave dhe ndërmarrja e masave administrative konform dispozitave ligjore në fuqi
- Kontrolli i vazhdueshëm i subjekteve recidiviste

10.3. Digjitalizimi dhe transparenca

- Regjistër elektronik i inspektimeve
- Raporte javore dhe vjetore të publikuara

10.4. Reagim më i shpejtë ndaj qytetarëve

- Trajtimi i rasteve në bazë të kategorizimit sipas urgjencës
- Minimizimi i afateve të veprimit dhe vendosjes

10.05. Sigurimi i rregullimit normativ të nevojshëm dhe kompletimi i kuadrit normativ.

11. Kapaciteti dhe Struktura Organizative e Drejtorisë së Inspektionit

Në kuadër të Drejtorisë së Inspektionit funksionojn këto sektore:

- Sektori i Tregut;
- Sektori i Shërbimeve Publike dhe Mbrojtje të Mjedisit;
- Sektori i Ndërtimit;
- Sektori i Transportit Rrugor;
- Zyra e Drejtorit të Drejtorisë.

12. Metodologjia e Mbikëqyrjes Inspektuese

Mbikëqyrja inspektuese realizohen përmes:

- Inspektimet e planifikuara
- Inspektimet e paplanifikuara
- Inspektimet e përbashkëta
- Riinspektimi

13. Planifikimi – Numri i Inspektimeve të Parashikuara

Numri i inspektimeve për vitin 2026 është parashikuar në përputhje me kapacitetet që ka Drejtoria e Inspektionit, problematikat dhe qasjen e bazuar në risk.

Numri i planifikuar i inspektimeve:

Lloji i inspektimit	Nr. i planifikuar
---------------------	-------------------

- Inspektime të planifikuara	1170
- Inspektime të paplanifikuara	487
- Inspektime të përbashkëta	77
- Riinspektime	409

14. Planifikimi i Inspektimeve Bazuar në Risk

13.1. Inspektorati komunal punojnë për të ofruar mbështetje për subjektet e inspektimit, planifikojnë inspektime bazuar në rreziqe dhe inspektojnë vetëm sipas planit të inspektimit, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

13.2. Risku si kriter vlerësohet sipas kritereve:

- Historiku i dukurisë (shkeljes)
- Numri i ankesave
- Ndikimi në mjedis
- Vendndodhja dhe lokacionet
- Numri i personave të përfshirë
- Sezonaliteti

15. Zonat me Risk të Lartë në Mitrovicën e Jugut

- Bajgorë
- Selac
- Kovaqicë
- Zhabar
- Suhadoll
- Gushave
- Qendra dhe tregu.

16. Kategoritë e Riskut

16.1. Risk i lartë

- Ndërtime pa leje
- Operimi i bizneseve të pa regjistruara
- Përdorimi i kundërligjshme i hapsirës publike
- Papastërtia në hapsirat publike
- Operimi ilegal i transportit të udhëtarëve dhe mallrave

Frekuenca: Javore dhe e pa paralajmëruar

16.2. Risk i mesëm

- Ndërtimi me leje ndërtimore
- Subjektet recidiviste
- Shfrytëzimi i trotuareve në veçanti në sezona

Frekuenca: mujore dhe e parashikuar

16.3. Risk i ulët

- Subjektet pa histori shkeljeje

Frekuenca: Gjashtë mujore dhe rastësore

17. Numri i Inspektimeve të Bazuara në Risk

Numri i inspektimeve të bazuara në risk fokusohet në subjekte dhe zona me nivel të lartë të shkeljesh, ndikim në shëndetin publik, mjedis dhe rend komunal. Prioritet kanë zonat problematike të evidentuara si më lartë dhe subjektet me histori shkeljesh të përsëritura.

Niveli i riskut	Nr. i inspektimeve
- Risk i lartë	1300
- Risk i mesëm	825
- Risk i ulët	234
Gjithësej:	2359

18. SEKTORI I TREGUT

Inspektorati i Tregut ka kompetencë mbikëqyrjen e tregut – si formë e veçantë e mbikëqyrjes inspektuese respektivisht mbikëqyr standardet e tregimit të mallrave dhe të cilësisë së shërbimeve që ofrojnë subjektet ekonomike në territorin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, si:

- Mbrojtjen e konsumatorëve;
- Përbushjen e standardeve të mallrave pas vendosjes së tyre në treg dhe të shërbimeve;
- Sigurinë e produkteve në treg;
- Përshtatshmërinë teknike të produkteve;
- Veprimtarinë turistike dhe hoteliere;
- Mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale në treg;
- Mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të ngjashme në treg;
- Veprimtarinë zejtare etj.

19. Fushëveprimi i inspektoratit të tregut

Kompetencat e Inspektoratit të Tregut bazohet në:

- Ligji nr. 08/L-067 për Inspektimet,
- Ligji nr. 08/L-279 për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut;
- Rregulloren nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale dhe akte tjera ligjore.

20. Prioritetet për vitin 2026 të bazuara në risk

- Parandalimi i ushtrimit të veprimtarive ilegale dhe të pa regjistruar;
- Kontrolli i tregimit të produkteve pa dokumentacion dhe origjinë të deklaruar;
- Paisja me PELQIME për plotësim e kushteve Teknike komfor U.A 2005/12;
- Mbrojtjen e të drejtës së konsumatorit;
- Vendosjen e çmimeve, mbajtësen dhe azhuritetin e librave dhe evidencës në subjekte afariste;
- Kontrollimi i dhënies së tiketave shitëse dhe respektimin e orarit të punës;
- Udhëzimet teknike dhe garancionet e mallrave si dhe saktësia e dokumentacionit përcjellës, etj.;
- Inspektimi i kushteve teknike të subjekteve afariste tregtare që merrën me shumicë dhe pakicë dhe subjektet shërbyese, etj.

21. Plani i inspektimit të Sektorit të Tregut

Për vitin 2026 janë paraparë të realizohen 655 inspektime në kuadër të këtij sektori, të klasifikuara si:

Lloji i inspektimit	Nr. i planifikuar
- Inspektime të planifikuar	300
- Inspektime të paplanifikuara	152
- Inspektim sipas parashtresës	81
- Inspektime të përbashkëta	3
- Ri inspektime	119

Tabela 1: Sektori i Tregut - Objektivat dhe aktivitetet e Planit Vjetor të Punës për vitin 2026

Nr.	Objektivi/detyra e punës	Aktivitetet
1	Luftimi i ekonomisë joformale dhe sigurimi i tregut të drejtë dhe konkurrues.	1.1. Regjistrimi i biznesit; 1.2. Verifikimi i kushteve minimale teknike dhe paisja e subjekteve me pelqim për të ushtruar veprimtari biznesore; 1.3. Origjina e mallit dhe mbajtja e evidencës; 1.4. Kontrollimi i qarkullimit të mullerave në automjete transportese etj.
2	Mbrojtja e konsumatorit, mbikëqyrja dhe ndërmarrja e masave për të parandaluar abuzimet në treg, mashtrimi i konsumatorëve përmes reklamave dhe portaleve elektronike.	2.1. Vendosija e çmimeve dhe verifikimi i çmimit të deklaruar; 2.2. Dhënja e faturave – kuponave konsumatorit; 2.3. Respektimi i garancioneve; 2.4. Kontrollimi i karakteristikave të produkteve përmes certifikatave, deklarimit dhe etiketimit etj; 2.5. Përmeshja e standardeve të mallrave pas vendosjes së tyre dhe të shërbimeve dhe përrshatëshmëria teknike e produkteve, etj;
3	Inspektimi i subjekteve shërbyese	3.1. Kontrollimi inspektues i veprimtarive turistike, hoteliere dhe zejtare; 3.2. Kontrollimi inspektues i Autoparkingjeve; 3.3 .Autolarjeve, Automekanikëve.

Tabela me detyrat e punës, veprimet dhe trupat përgjegjëse, të klasifikuara sipas prioriteteve në muaj të caktuar

JANAR 2026

Detyrat e punës	Veprimet/Masat	Inspektorët	Mbikëqyrësi
1. Inspektimi i dyqane tregtare si: Ushqimore dhe jo ushqimore: 1.1. Vendorsja e çmimeve – origjina e mallit 1.2. Etiketën dhe deklaracionet e mallit 1.3. Vendorsja e flamujve te origjinës 1.4. Shitjet ne aksion 1.5. Zbritje sezonale e 1.6. Vendorsja e çmimeve në zbritje dhe përqindja me çmimin përfundimtar të deklaruar; 1.7. Përmbyshja e standardeve të mallrave pas vendorsjes së tyre dhe të shërbimeve dhe Përshtatshmëria teknike e produkteve, etj. 2. Përgatitja e planit javor në punës; 3. Raporti i aktivitetit inspektues.	- Udhëzime; - Sugjerime; - Vërejtje; - Aktvendime; etj.	Inspektorët e Sektorit	Udhëheqësi i Sektorit

SHKURT 2026

Detyrat e punës	Veprimet/Masat	Inspektorët	Mbikëqyrësi
1. Inspektimi i dyqane tregtare si: Ushqimore dhe jo ushqimore: 1.1. Etiketën dhe deklaracionet e mallit; 1.2. Vendorsja e flamujve te origjinës; 1.3. Vendorsja e çmimeve në zbritje dhe përqindja me çmimin përfundimtar të deklaruar; 1.4. Përmbyshja e standardeve të mallrave pas vendorsjes së tyre dhe të shërbimeve dhe 1.5. Përshtatshmëria teknike e produkteve, etj. 2. Inspektim i produkteve në zbritje të deklaruar: 2.1. Shitjet ne aksion; 2.2. Zbritje sezonale; 3. Përgatitja e planit javor në punës; 4. Raporti i aktivitetit inspektues.	- Udhëzime; - Sugjerime; - Vërejtje; - Aktvendime etj.	Inspektorët e Sektorit	Udhëheqësi i Sektorit

MARS 2026

Detyrat e punës	Veprimet/Masat	Inspektorët	Mbikëqyrësi
1. Inspektimi i subjekteve – vendosja e çmimit për shërbime etj.. 1.1. Dyqane zejtare - shërbyese 1.2. Automekanik; 1.3. Autolimar; 1.4. Sallon ondulomi; 1.5. Sallone mjeshtrie-sallduese, shërbyes,etj; 1.6. Autolarje; 1.7. Auto-parkingje; 2. Përgatitja e planeve javore në punës; 3. Raporti i aktivitetit inspektues.	- Udhëzime; - Sugjerime; - Vërejtje; - Aktvendime etj.	Inspektorët e Sektorit	Udhëheqësi i Sektorit

PRILL 2026

Detyrat e punës	Veprimet/Masat	Inspektorët	Mbikëqyrësi
1. Inspektime ne subjektet –Vendosja e çmimeve: 1.1. Internet caffè; 1.2. DPH; 1.3. Bukëpjekës-Furra buke; 1.4. Tregtimi i duhanit; 2. Përgatitja e planeve javore në punës; 3. Raporti i aktivitetit inspektues.	- Udhëzime; - Sugjerime; - Vërejtje; - Aktvendime etj.;	Inspektorët e Sektorit	Udhëheqësi i Sektorit

MAJ 2026			
Detyrat e punës	Veprimet/Masat	Inspektorët	Mbikëqyrësi
1. Inspektimi i subjekteve depo me shumicë Jo-ushqimore; 1.1. Material ndërtimor; 1.2. Shitja e inventarizimit shtëpiak; 1.3. Qendra e biznesit - subjekte prodhuese; 1.4. Terminali doganor - subjekte shërbyese; 1.5. Kontrollimi i mallit - ngjyra – polikollor; 1.6. Tregtimi i duhanit; 2. Përgatitja e planeve javore në punës; 3. Raporti i aktivitetit inspektues.	- Udhëzime; - Sugjerime; - Vërejtje; - Aktvendime etj.	Inspektorët e Sektorit	Udhëheqësi i Sektorit
QERSHOR 2026			
Detyrat e punës	Veprimet/Masat	Inspektorët	Mbikëqyrësi
1. Inspektime të rregullta në veprimtari Hoteliere dhe Internet caffè; 1.1 Vendorsja e çmimeve dhe verifikimi i çmimit të deklaruar; 1.2 Dhënia e faturave – kuponëve konsumatorit; 1.3 Respektimi i garancioneve; 1.4 Kontrollimi i karakteristikave të produkteve përmes certifikatave, deklarimit dhe etiketimit etj. 1.5 Përmbushja e standardeve të mallrave pas vendosjes së tyre dhe të shërbimeve dhe përshtatshmëria teknike e produkteve; 2. Mbikëqyrja e respektimit të orarit të punës; 3. Përgatitja e planeve javore në punës; 4. Raporti i aktivitetit inspektues.	- Udhëzime; - Sugjerime; - Vërejtje; - Urdhëresa - Aktvendime , etj.	Inspektorët e Sektorit	Udhëheqësi i Sektorit

Plotësim: Aktivitet në grupe sipas Rregullores Nr. 24/2020 - Inspektimi i produkteve në treg në bashkëpunim me organet tjera

KORRIK 2026

Detyrat e punës	Veprimet/Masat	Inspektorët	Mbikëqyrësi
1. Inspektimi i dyqane tregtare si: Ushqimore dhe jo ushqimore; 1.1 Etiketën dhe deklaracionet e mallit; 1.2. Vendosja e flamujve te origjinës; 2. Inspektim i produkteve në zbritje të deklaruar; 2.1 Shitjet ne aksion; 2.2 Zbritje sezonale; 2.3 Vendosja e çmimeve në zbritje dhe përqindja me çmimin përfundimtar të deklaruar; 3. Përgatitja e planit javor në punës. Inspektimi i subjekteve ;	- Udhëzime; - Sugjerime; - Vërejtje; - Aktvendime; Etj.	Inspektorët e Sektorit	Udhëheqësi i Sektorit

GUSHT 2026

Detyrat e punës	Veprimet/Masat	Inspektorët	Mbikëqyrësi
1. Inspektimi i subjekteve; 1.1. DPH; 1.2. Internet caffè, lojëra zbavitëse; 1.3. Inspektim i produkteve në zbritje të deklaruar; vendosja e çmimeve në zbritje dhe përqindja me çmimin përfundimtar të deklaruar; 2. Mbikëqyrja a respektimi të orarit të punës; 3. Përgatitja e planeve javore në punës; 4. Raportet javore të punës.	- Udhëzime; - Sugjerime; - Vërejtje; - Urdhëresa - Aktvendime; etj.	Inspektorët e Sektorit	Udhëheqësi i Sektorit

Plotësim: Aktivitetet në grupe sipas Rregullores Nr. 24/2020 - Inspektimi i produkteve në treg në bashkëpunim me organet tjera.

SHTATOR 2026

Detyrat e punës	Veprimet/Masat	Inspektorët	Mbikëqyrësi
1. Inspektimi i subjekteve ; 2. Dyqanet tregtare-jo ushqimore; 3. Inspektim i produkteve ne zbritje te deklaruar, vendosja e çmimeve ne zbritje dhe përqindja me çmimin përfundimtar te deklaruar ; 5. Mbikëqyrja a respektimi të orarit të punës; 6. Përgatitja e planeve javore në punës; 7. Raportet javore të punës.	- Udhëzime; - Sugjerime; - Vërejtje; - Urdhëresa; - Aktvendime etj	Inspektorët e Sektorit	Udhëheqësi i Sektorit

TETOR 2026

Detyrat e punës	Veprimet/Masat	Inspektorët	Mbikëqyrësi
1. Inspektimi i subjekteve: 1.1. Dyqane zejtare - shërbyese; 1.2. Automekanik; 1.3. Auto-limar; 1.4. Sallone mjeshtrie-salldues, shërbyes; 1.5. Autolarje; 1.6. Auto-parkingje; 2. Përgatitja e planeve javore në punës; 3. Raportet javore të punës.	- Udhëzime; - Sugjerime; - Vërejtje; - Urdhëresa; - Aktvendime; etj.	Inspektorët e Sektorit	Udhëheqësi i Sektorit

NËNTOR 2026

Detyrat e punës	Veprimet/Masat	Inspektorët	Mbikëqyrësi
1. Inspektimi i subjekteve; 2. Inspektim i produkteve , vendosja e çmimeve në zbritje dhe përqindja me çmimin përfundimtar të deklaruar; 3. Tregtimi i duhanit; 4. Mbikëqyrja a respektimi të orarit të punës. 5. Përgatitja e planeve javore në punës; 6. Raportet javore të punës.	- Udhëzime; - Sugjerime; - Vërejtje; - Urdhëresa; - Aktvendime; etj	Inspektorët e Sektorit	Udhëheqësi i Sektorit

DHJETOR 2026

Detyrat e punës	Veprimet/Masat	Inspektorët	Mbikëqyrësi
1. Inspektimi i subjekteve ; 1.1. Dyqane hoteliere; 1.2. Restorante; 1.3. Bar kafe; 1.4. Ëmbëltore etj. 2. Mbikëqyrja a respektimi të orarit të punës; 3. Raporti i aktivitetit inspektues; 4. Përgatitja e Planit Vjetor të Punës.	- Udhëzime; - Sugjerime; - Vërejtje; - Urdhëresa; - Aktvendime; Etj.	Inspektorët e Sektorit	Udhëheqësi i Sektorit

22. SEKTORI I SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Ky sektor mbikëqyr zbatimin e legjislacionit dhe rregulloreve komunale në fushën e shërbimeve publike dhe mbrojtjes së mjedisit, respektivisht ushtron mbikëqyrje inspektuese në këto fusha:

- Shfrytëzimi i sipërfaqes publike.
- Vendosja e objekteve të përkohshme dhe paisjeve tjera në sipërfaqe publike.
- Vendosja dhe mirëmbajtja e objekteve reklamuese, pano-ve dhe elementeve tjera promovuese.
- Parandalimi dhe trajtimi i dëmtimeve në sipërfaqe publike dhe infrastrukturë urbane.
- Mbikëqyrja e pastërtisë publike dhe menaxhimit të mbeturinave.
- Identifikimi dhe eliminimi i deponive ilegale.
- Mirëmbajtja e hapësirave publike dhe të gjelbëruara.
- Mbikëqyrja e ndriçimit publik dhe pajisjeve-objekteve komunale.
- Kontrolli i ndotjes së mjedisit.
- Mbikëqyrja e ofrimit të shërbimeve publike nga ndërmarrjet publike.

23. Fushëveprimi i inspektoratit të shërbimeve publike dhe mbrojtjes së mjedisit

Inspektorët e Inspektionit të Sektorit për Shërbime Publike dhe Mbrojtje të Mjedisit, vepron në bazë të dispozitave të:

- Ligji për Zyrarët Publik;
- Ligji nr. 08/L-067 për Inspektimet;
- Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative;
- Ligjit mbi Kundërvajtjet;
- Ligji Nr. 04/L-060 Për Mbeturina;
- Rregullore nr. Nr.01/2023 për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike;
- Rregullores 03/2012 për shërbime publike komunale dhe rend komunal;
- Rregullorja Nr.02/2022 për menaxhimin e mbeturinave;
- Rregullores Nr.01/2022 për Organizimin Kompetencat dhe Përgjegjësit e Administratës komunale;
- Ligjeve, Rregulloreve dhe Vendimeve tjera të cilat përcaktojnë punën, kompetencat dhe fushëveprimin e inspektorëve, si dhe në bazë të këtij plan-programi, do të kryejnë, këto punë:

24. Prioritetet për vitin 2026 të bazuara në risk

- Parandalimi i shfrytëzimit të paautorizuar të sipërfaqës publike;
- Parandalimi dhe zvogëlimi i dëmtimeve të hapsirës publike dhe infrastrukturës publike;
- Vendosja e rregullit në reklamimin urban;
- Eliminimi deponive ilegale dhe ndotjes mjedisore;
- Mbikëqyrja efektive e cilësisë së shërbimeve publike;
- Trajtimi me prioritet të ankesave të qytetarëve

25. Plani i inspektimit të Sektorit të Shërbimeve Publike dhe Mbrojtje të Mjedisit

Për vitin 2026 janë paraparë të realizohen 680 inspektime në kuadër të këtij sektori, të klasifikuara si:

Lloji i inspektimit	Nr. i planifikuar
- Inspektime të planifikuar	420
- Inspektime të paplanifikuara	110
- Inspektim sipas parashtrësës	50
- Inspektime të përbashkëta	20
- Ri inspektime	80

Tabela 2: Sektori për Shërbime Publike dhe Mbrojtje të Mjedisit - Objektivat dhe aktivitetet e Planit Vjetor të Punës për vitin 2026

Nr.	Objektivi/detyra e punës	Aktivitetet
1	Inspektime për dëmtimin dhe shfrytëzimin e hapësirave publike.	1.1 Kontrolle inspektuese në teren; 1.2 Aksionet e organizuara nga Drejtoria e Inspektionit për lirim të hapësirave publike;
2	Inspektime për gjendjen e pastërtisë në hapësirat publike.	2.1 Kontrolle inspektuese në teren; 2.2 Bashkëpunim me KRM „Uniteti”; 2.3 Organizim i aksioneve për pastrimin e qytetit, në bashkëpunim me Drejtorinë e ambientit, OJQ-të etj;
3	Vendosja komfor ligjeve, akteve tjera nënligjore të objekteve të përkohshme, mbishkrimet, panot dhe tabelat reklamuese.	3.1 Kontrolle inspektuese; 3.2 Respektimi i afateve të dhëna me Procesverbale dhe Aktvendime;
4	Përgjigja në kërkesat zyrtare të qytetarëve.	4.1 Kontrolle inspektuese; 4.2 Respektimi i afateve të dhëna me Procesverbale dhe Aktvendime; 4.3 Bashkëpunimi me KR. Ujësjetësi, KRM. UNITETI, KEDS, PTK, Policinë etj;
5	Inspektime për mbrojtjen e mjedisit	5.1 Kontrolle inspektuese; 5.2 Respektimi i afateve të dhëna me Procesverbale dhe Aktvendime;

Në kohën e Planifikimit të Planit vjetor të punës 2026 Sektori për SHPMN nuk ka Inspektor të Mbrojtjes së Mjedisit, andaj objektivi i pestë do të zbatohet prej momentit të pranimit në punë të inspektorëve kompetent

JANAR 2026

Detyrat e punës	Veprimet	Inspektorët	Mbikëqyrësi
1. Pastrimi e trotuareve dhe rrugëve nga bora; 2. Konstatimi i gjendjes së pastërtisë dhe ndërmarrja e masave të parapara për përmirësimin e gjendjes së pastërtisë; 3. Inspektimi i subjekteve afariste të cilat bëjnë shfrytëzimin e hapësirave publike pa leje përkatëse; 4. Inspektim i subjekteve afariste të cilat kanë vendos reklama, pano, tabela reklamuese, bill-boarde, city-light, banerë etj; 5. Pranimi dhe vendosja e kërkesave të palëve; 6. Mbyllja e lëndëve të pa mbyllura; 7. Inspektim i subjekteve afariste, ndërtimore të cilat bëjnë ndotjen e ambientit; 8. Edhe punë tjera të caktuara nga Drejtori i DI.	- Udhëzime; - Sugjerime; - Vërejtje; - Urdhëresa; - Procesverbale; - Njoftime; - Aktvendime; - Fletëparaqitje; - Etj.	Inspektorët e Sektorit	Udhëheqësi i Sektorit

SHKURT 2026

Detyrat e punës	Veprimet/Masat	Inspektorët	Mbikëqyrësi
1. Konstatimi i gjendjes së pastërtisë në qytet, dëmtimet eventuale dhe ndërmarrja e masave të parapara për përmirësimin e gjendjes së pastërtisë, sidomos para lokaleve afariste; 2. Pastrimin e trotuareve dhe rrugëve nga bora; 3. Inspektimi i subjekteve afariste dhe tregtarëve ilegal të cilat bëjnë shfrytëzimin e hapësirave publike pa leje përkatëse; 4. Inspektim i subjekteve afariste të cilat kanë vendos reklama, pano, tabela reklamuese, bill-boarde, city-light, banerë etj; 5. Pranimi dhe vendosja e kërkesave të palëve; 6. Inspektimi i stacionit të Autobusve për gjendjen	- Udhëzime; - Sugjerime; - Vërejtje; - Urdhëresa; - Procesverbale; - Njoftime; - Aktvendime; - Fletëparaqitje; - Etj.	Inspektorët e Sektorit	Udhëheqësi i Sektorit

e pastërtisë;			
7. Inspektimi i ambienteve të jashtme të Qendrave tregtare;			
8. Inspektim i subjekteve afariste, ndërtimore të cilat bëjnë ndotjen e ambientit.			

MARS 2026

Detyrat e punës	Veprimet/Masat	Inspektorët	Mbikëqyrësi
1. Inspektimi i sipërfaqeve publike, konstatimi i gjendjes së pastërtisë dhe ndërmarrja e masave të parapara për përmirësimin e gjendjes së pastërtisë, sidomos para lokaleve afariste; 2. Inspektim i subjekteve afariste të cilat kanë vendos reklama, pano, tabela reklamuese, bill-board, city-light, banerë etj; 3. Vazhdimi i inspektimeve të subjekteve afariste dhe tregtarëve ilegal, të cilat bëjnë shfrytëzimin e hapësirave publike, pa leje përkatëse; 4. Pranimi dhe vendosja e kërkesave të palëve; 5. Inspektimi i shkollave për gjendjen e pastërtisë; 6. Inspektim i subjekteve afariste, ndërtimore të cilat bëjnë ndotjen e ambientit.	- Udhëzime; - Sugjerime; - Vërejtje; - Urdhëresa; - Procesverbale; - Njoftime; - Aktvendime; - Fletëparaqitje; Etj.	Inspektorët e Sektorit	Udhëheqësi i Sektorit

PRILL 2026

Detyrat e punës	Veprimet/Masat	Inspektorët	Mbikëqyrësi
1. Konstatimi i gjendjes se pastërtisë, sidomos para lokaleve afariste; 2. Vazhdimi i inspektimeve të subjekteve afariste dhe tregtarëve ilegal të cilat bëjnë shfrytëzimin e hapësirave publike, pa leje përkatëse; 3. Inspektim i subjekteve afariste të cilat kanë vendos reklama, pano, tabela reklamuese, bill-board, city-light, banerë etj; 4. Pranimi dhe vendosja e kërkesave të palëve; 5. Inspektimi i shkollave për gjendjen e pastërtisë; 6. Edhe punë tjera të caktuara nga Drejtori i DI.; 7. Inspektim i subjekteve afariste, ndërtimore të cilat bëjnë ndotjen e ambientit.	- Udhëzime; - Sugjerime; - Vërejtje; - Urdhëresa; - Procesverbale; - Njoftime; - Aktvendime; - Fletëparaqitje; - Etj.	Inspektorët e Sektorit	Udhëheqësi i Sektorit

MAJ 2026

Detyrat e punës	Veprimet/Masat	Inspektorët	Mbikëqyrësi
1. Inspektimi i sipërfaqeve publike, konstatimi i gjendjes se pastërtisë, dëmtimet eventuale te hapësirave publike; 2. Vazhdimi i inspektimeve të subjekteve afariste të cilat bëjnë shfrytëzimin e hapësirave publike pa leje përkatëse; 3. Inspektim i subjekteve afariste të cilat kanë vendos reklama, pano, tabela reklamuese, bill-board, city-light, banerë etj; 4. Pranimi dhe vendosja e kërkesave të palëve; 5. Mbyllja e lëndëve të pa mbyllura;	- Udhëzime; - Sugjerime; - Vërejtje; - Urdhëresa; - Procesverbale; - Njoftime; - Aktvendime; - Fletëparaqitje; - Etj.	Inspektorët e Sektorit	Udhëheqësi i Sektorit

6. Inspektimi i varrezave në Shipol për konstatimin e gjendjes së pastërtisë;			
7. Inspektim i subjekteve afariste, ndërtimore të cilat bëjnë ndotjen e ambientit.			

QERSHOR 2026

Detyrat e punës	Veprimet/Masat	Inspektorët	Mbikëqyrësi
1. Inspektimi i sipërfaqeve publike, konstatimi i gjendjes së pastërtisë dhe dëmtimet eventuale të hapësirave publike; 2. Vazhdimi i inspektimeve të subjekteve afariste të cilat bëjnë shfrytëzimin e hapësirave publike, pa leje përkatëse; 3. Inspektim i subjekteve afariste të cilat kanë vendos reklama, pano, tabela reklamuese, bill-board, city-light, banerë etj; 4. Pranimi dhe vendosja e kërkesave të palëve; 5. Inspektim i subjekteve afariste, ndërtimore të cilat bëjnë ndotjen e ambientit.	- Udhëzime; - Sugjerime; - Vërejtje; - Urdhëresa; - Procesverbale; - Njoftime; - Aktvendime; - Fletëparaqitje; Etj.	Inspektorët e Sektorit	Udhëheqësi i Sektorit

KORRIK 2026

Detyrat e punës	Veprimet/Masat	Inspektorët	Mbikëqyrësi
